




British Embassy
Pristina

BIRN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | KOSOVO

Partitë e Punësimeve

Raporti i monitorimit të rekrutimit
(dhjetor 2019 - dhjetor 2020)



Prishtinë, 2020

Partitë e Punësimeve

Raporti i monitorimit të rekrutimit
(dhjetor 2019 - dhjetor 2020)

Prishtinë,
Dhjetor 2020

Autore:

Dorentina Kastrati

Kontributor:

Kastriot Berisha

Emirjeta Vllahiu

Drenushë Ramadani

Xheneta Murtezaj

Valon Fana

Redaktor:

Visar Prebreza

Lektura:

Përparim Isufi

Shkurtesat

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK - Agjencia Kundër Korrupsion

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BIRN - Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese

KE - Kryeshef Ekzekutiv

KEK - Korporata Energjetike e Kosovës

KOSTT - Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike të Kosovës

KPM - Komisioni i Pavarur për Media

KPMSHC - Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

LVV - Lëvizja Vetëvendosje

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

NP - Ndërmarrje Publike

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

RTK - Radio Televizioni i Kosovës

SKQZ - Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

ShSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

ZKM - Zyra e Kryeministrit të Kosovës

ZRrE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	7
2. VLERËSIMET SEKRETE NË KONKURSE	9
3. VITI I SHKARKIMEVE	19
4. PUNËSIMET ME TENDERË	25
5. KOSTO E PUNËSIMEVE JO-MERITORE	28
6. PUNËSIMET POLITIKE DHE FAMILJARE NË INSTITUCIONE	32
7. REKOMANDIMET	35

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Interesi për t'i kontrolluar ndërmarrjet publike nga politika është dëshmuar edhe këtë vit, kur Kosova brenda një viti kishte tre kryeministra që vinin nga tri parti të ndryshme: Ramush Haradinaj (AAK), Albin Kurti (LVV) dhe Avdullah Hoti (LDK). Secila prej qeverive shpërfaqti fytyrën kur është puna tek emërimi i bordeve të ndërmarrjeve publike të cilat janë në gjendje të vështirë por megjithatë kanë qarkullime milionëshe.

Bordet politike të emëruara nga Qeveria Haradinaj të cilat, sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, bënë shumë shkelje gjatë punës së tyre, u shkarkuan nga Qeveria Kurti. Qeveria Kurti i zëvendësoi bordet e përkohshme, në mesin e të emëruarve të rinj ishin katër persona me të kaluar politike dhe një financues i Vetëvendosjes.

Pas ardhjes në pushtet të Qeverisë Hoti, këto borde të përkohshme sërish u shkarkuan me arsyetimin e mosbindjes ndaj qeverisë e cila kërkonte që të anuloheshin konkurset për zyrtarë të lartë nëpër këto ndërmarrje. Pra, shkarkimi ka ndodhur pikërisht për shkak të luftës për kontroll në ndërmarrje publike. Kjo është dëshmia më e mirë për synimet e politikës për të kontrolluar ndërmarrjet publike, të cilat këtë vit janë shtyrë të operojnë me borde të përkohshme, pasiguri në menaxhim e më shumë humbje.

Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka hapur konkurse për bordet e ndërmarrjeve publike. Disa prej këtyre konkurseve janë duke u asistuar edhe nga BDO-ja, kompania e angazhuar nga Ambasada Britanike për të ofruar asistencë në rekrutim. Këto konkurse ende janë në proces dhe pritet që shumë shpejt të fillojë intervistimi i kandidatëve që i kanë plotësuar kriteret minimale. Ka një interesim shumë të madh për të qenë pjesë e bordeve, pasi konkurrenca është e madhe saqë vetëm për një bord kanë aplikuar mbi 200 kandidatë.

Pas rekomandimit të BIRN-it, Zyra e Kryeministrit të Kosovës për herë të parë u ka imponuar komisioneve vlerësuese që të shikojnë edhe të kaluarën politike të secilit kandidat, duke kërkuar të dhëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga Thesari i Shtetit. KQZ-ja ka ofruar informata nëse kandidatët për anëtarë të bordeve kanë qenë kandidatë nëpër zgjedhje qendrore apo lokale, kurse Thesari i Shtetit ka ofruar informacione nëse kandidatët për borde kanë mbajtur poste politike nëpër institucione.

Kështu, për herë të parë Qeveria ka bërë hapa konkretë për të zbatuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike i cili kërkon që personat e emëruar duhet të jenë të pavarur në atë mënyrë që në 36 muajt e fundit të mos kenë mbajtur pozita politike nëpër institucione apo ndërmarrje publike. Aktualisht vetëm personat që kanë pozita nëpër parti politike nuk mund të gjurmohen dhe t'u parandalohet zgjedhja nëpër borde të ndërmarrjeve publike.

Konkurset e hapura dhe të zhvilluara nga Kuvendi i Kosovës janë zhvilluar me shumë probleme. Pjesa më e madhe e konkurseve janë mbajtur pa asistencën e BDO-së, kompanisë britanike. Këto konkurse nuk kanë qenë transparente. Deputetët kanë aplikuar një mënyrë të vlerësimit që nuk lënë gjurmë se cili deputet sa poena i ka dhënë një kandidati.

Një vlerësim i tillë jotransparent e sekret e humb rëndësinë e intervistave me qëllim poentimi bëhet në bazë të lidhjeve politike dhe jo në bazë të meritokracisë apo performancës në intervista. E njëjta mënyrë e vlerësimit është aplikuar nga KQZ me rastin e zgjedhjes së kryeshefit të Sekretariatit.

BIRN për herë të parë ka filluar monitorimin e konkursit të Forcës së Sigurisë së Kosovës për ushtarë. Në këtë konkurs kanë aplikuar mbi 5,000 persona, ndërsa në fund do të zgjidhen vetëm 400 ushtarë. Ky është konkursi më i madh i monitoruar ndonjëherë, ndërsa vetëm testi fizik ka zgjatur 30 ditë dhe janë testuar mbi 4,000 persona. Rezultatet e këtij konkursi, duke përfshirë impaktin e monitorimit të BIRN-it, do të publikohen vetëm pas mbylljes së këtij konkursi.

Përveç monitorimit direkt, BIRN ka raportuar për shumë konkurse në të cilat kishte shkelje dhe që kishin rezultuar me zgjedhjen e personave jomeritorë e shpeshherë edhe të lidhur me politikën. Ndërsa, fokus i monitorimit ishte edhe puna që kanë bërë institucionet, bordet e të cilave ishin zgjedhur në konkurset e monitoruara nga BIRN apo që janë asistuar nga BDO-ja. Dy nga këto institucione, bordet e të cilave janë emëruar pa rekomandimin e ekspertëve britanikë kishin një performancë jo të mirë: Telekom i Kosovës dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Këtë vit, për herë të parë do të ndalohet praktika e punësimeve përmes kontratave mbi vepër. Tashmë, në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, punësimet e përkohshme të ekspertëve lejohet të bëhen përmes Ligjit të Prokurimit. Marrë parasysh se prokurimi është problematik e me shumë shkelje, ka rrezik që kjo mundësi ligjore që të punësohen persona me kontrata deri në 36 muaj të keqpërdoret për punësimin e personave të lidhur me politikën.

2. VLERËSIMET SEKRETE NË KONKURSE

Kuvendi i Kosovës i ka përzgjedhur disa pozita të rëndësishme shtetërore përmes konkurseve të hapura, por jotransparente. Kandidatët janë poentuar në mënyrë të fshehtë nga deputetet në një fletë të bardhë, por në të cilën nuk e kanë shkruar emrin e tyre duke e bërë të pamundur të dihet se cili deputet me sa pikë e ka poentuar një kandidat. Kjo mënyrë e poentimit është kthyer në praktikë në konkurset e hapura nga Kuvendi i Kosovës, kryesisht në konkurset që janë zhvilluar pa asistencën e partnerit britanik, BDO.

Deputetet e Kuvendit të Kosovës nuk i kanë zbatuar praktikatat e vlerësimit të kandidatëve që janë vendosur nga BDO-ja, kompania angleze e angazhuar për t'i ofruar asistencë insitucioneve të Kosovës në rekrutimin e pozitave të larta drejtuese. Ky vlerësim sekret është bërë nga komisionet vlerësuese për zgjedhjen e bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT), anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) dhe Avokatit të Popullit. Njëjtë ka ndodhur edhe me konkursin për Kryeshef Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ).

Një mënyrë e tillë e poentimit të kandidatëve pamundëson monitoruesit për të vlerësuar nëse deputetet e Kuvendit të Kosovës kanë bërë vlerësime objektive. Gjithashtu, kjo praktikë lejon deputetet që të poentojnë kandidatët pa dhënë asnjë sqarim apo arsyetim për pikët e dhëna, siç është praktika e BDO-së që poentimet e bëra në shpërputhje me shumicën të argumentohen.

Në konkurset që zhvillohen me asistencën e BDO-së, partnerit të Ambasadës Britanike, anëtarët e komisionit vlerësues janë të obliguar të mbajnë shënime gjatë kohës sa një kandidat përgjigjet. Gjithashtu, ata janë të obliguar të shkruajnë anët pozitive dhe negative të kandidatëve. Përveç kësaj, ata duhet që pikët e dhëna për secilën përgjigje që ka dhënë kandidati t'i bëjnë publike para të gjithë anëtarëve të komisionit dhe monitoruesve. Anëtarët e Komisionit vlerësues duhet që t'i argumentojnë pikët e dhëna për përgjigje të caktuara nëse vlerësimi i kandidatit dallon nga mesatarja e pikëve të dhëna nga shumica e anëtarëve të komisionit.

Kjo mënyrë e vlerësimit dhe obligimi për t'i arsyetuar pikën, siç aplikohet në konkurset e asistuar nga BDO-ja, bën që secili anëtar i Komisionit Vlerësues të jetë sa më objektiv në pikët e dhëna. Kjo praktikë e mirë, përkundër që është aplikuar tash e një kohë të gjatë në konkurset e hapura nga Kuvendi, e të asistuar nga BDO-ja, nuk është aplikuar nga deputetet për konkursin për Avokatin e Popullit.

Një praktikë e tillë, e instaluar nga BDO-ja, në të kaluarën ka bërë që anëtarët e komisioneve vlerësuese të jenë sa më objektivë në vlerësimet e bëra. Ndërsa, praktika e vendosur nga Kuvendi i Kosovës ka bërë që vlerësimi dhe poentimi i kandidatëve të bëhet në baza politike dhe jo në bazë të meritokracisë apo performancës së kandidatit gjatë intervistimit. Një praktikë e tillë ka bërë që pazari për pozita të larta të nisë para se emrat të shkojnë në seancën e Kuvendit të Kosovës për votim.

2.1. BORDI I KOSTT

Konkursi i parë i kësaj legjislature të Kuvendit të Kosovës që është aplikuar vlerësimi sekret dhe i mbyllur ishte për anëtarë të bordit të KOSTT. Komisioni Vlerësues i përbërë nga deputetët: Endrit Shala, Pal Lekaj, Ferat Shala, Elbert Krasniqi, Doruntinë Maloku dhe Zoran Mojsilović për dy ditë ka intervistuar 27 kandidatë që kanë aplikuar për 5 pozita në bordin e KOSTT, institucion i cili mbi 2 vjet ka qenë pa bord. Ky konkurs është shpallur më 22 shkurt 2020.

Pas përfundimit të intervistimit të të gjithë kandidatëve, kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Endrit Shala, ka kërkuar nga koordinatori i Komisionit që t'i fotokopjojë 6 fleta me emrat e 27 kandidatëve të intervistuar, por pa emrat e deputetëve në to. Kjo praktikë është bërë në mënyrë që secili prej deputetëve të poentojë kandidatët por të mos bëhet e ditur se cili deputet me nga sa pikë i ka vlerësuar kandidatët. Ky proces nuk është kundërshtuar nga asnjë anëtar i Komisionit Vlerësues.

Po ashtu, kryetari i Komisionit, Endrit Shala, ka kërkuar nga monitoruesja e BIRN që të largohet nga salla ku do të bëhej vlerësimi. Gjatë kohës së vlerësimit dhe hartimit të listës me kandidatët që janë dërguar në Kryesi të Kuvendit, në sallë kanë qenë vetëm deputetët e Komisionit Vlerësues dhe koordinatori i Komisionit Parlamentar. Kjo mënyrë e poentimit është bërë në fund të procesit të intervistimit, pra vlerësimi është bërë pasi janë mbajtur 27 intervista.

Përveç vlerësimit 'sekret'¹, anëtarët e Komisionit vlerësues nuk janë sfiduar për t'i argumentuar pikët e dhëna për kandidatë, siç ndodh në konkurset që zhvillohen me asistencë të ekspertëve britanikë. Kjo mënyrë e vlerësimit bën që anëtarët e Komisionit të mos sfidohen për t'i argumentuar pikët e dhëna. Një mënyrë e tillë e vlerësimit është e paprecedent për konkurset e mëparshme për pozitat e larta drejtuese nëpër institucionet e Kosovës. Kjo ka bërë që kandidatët të vlerësohen me maksimumin e pikëve të mundshme.

KRITERET PËR KUSHËRINJË



KRITERET PËR PROFESIONISTË



¹ <https://kallxo.com/gjate/konkursi-me-probleme-vleresimi-sekret-per-kandidatet-per-bord-te-kostt-it/>

Gjatë vitit të kaluar ishte zhvilluar një proces i rekrutimit për bord të KOSTT-it me asistencë të ekspertëve britanikë që ofronin mbështetje profesionale për rekrutimin në pozitat e larta. Ai proces ka qenë transparent dhe secili anëtar i Komisionit vlerësues është obliguar që t'i arsyetojë pikët e dhëna për kandidatët. Poentimi ishte bërë pas çdo kandidati, ndërsa secili nga anëtarët është obliguar t'i arsyetojë pikët e dhëna. Por, ky proces i rekrutimit kishte dështuar, meqë Kuvendi i Kosovës për gjashtë muaj nuk kishte arritur të votojë kandidatët e propozuar dhe miratuar edhe nga BDO-ja. Ndërsa, me shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve, konkursi ishte anuluar.

Lista prej 12 kandidatëve që kanë shkuar para deputetëve të Kuvendit të Kosovës është përbërë nga 8 burra dhe 4 gra: Kushtrim Krasniqi, Jeton Mehmeti, Ali Hamiti, Nebih Zariqi, Pranvera Dobruna – Kryeziu, Saranda Sadriu – Mehmeti, Xhavit Buzhala, Ibrahim Krasniqi, Gjelosh Vataj, Ajrinë Gashi – Hamdiu, Arben Dodaj dhe Hyrmet Mydyti.

Komisioni vlerësues nuk i ka bërë pyetjet e njëjta të gjithë 27 kandidatëve të intervistuar. 14 kandidatët që janë intervistuar ditën e parë janë përballur me pyetje të ndryshme nga 13 kandidatët e ditës së dytë të intervistimit. Përveç diskriminimit në pyetje, kandidatët janë diskriminuar edhe në kohën e intervistimit.

BIRN ka evidentuar një anim të hapur të disa prej anëtarëve të komisionit vlerësues me kandidatë të caktuar. Në një rast, gjatë parashtrimit të pyetjes nga deputeti i PDK-së, Ferat Shala, për kandidatin Ibrahim Krasniqi ai tha “e njoh qe një jetë të tërë, e kam edhe vendas, me qenë mundësi nuk të kisha bo hiç pyetje por qe, po u dashka me të bo pyetje”. Kandidati në fund të procesit të vlerësimit ka hyrë në mesin e 12 kandidatëve që janë dërguar në Kuvend. BIRN nuk ka pasur qasje në vlerësim për të parë nëse afërsia e Shalës me kandidatin Krasniqin ka ndikuar në poentim.

Rasti tjetër është përsëritur me kandidatin Ali Hamiti, vëllanë e ish-deputetit të LDK-së, Sabri Hamiti. Gjatë intervistimit, deputetët Ferat Shala dhe Pal Lekaj nuk kanë parashtruar pyetjet e tyre fare për kandidatin Ali Hamiti. Deputeti Ferat Shala tha “fat dhe shëndet, na ke nderu. Unë po du me thy shabllonin, tërhiqem prej kësaj pyetjes. Të uroj fat dhe shëndet, unë e mora përgjigjen time” kurse deputeti Pal Lekaj tha “as unë nuk po bëj pyetje, përgjigja u konsumua më herët. Ju përgëzoj për punën”.

Disa kandidatë të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs për anëtarë të bordit të KOSTT, kanë aplikuar edhe në konkursin e kaluar ku ka qenë e përfshirë edhe BDO dhe janë vlerësuar më shumë. Kandidati Enis Berisha, sipas Komisionit aktual, është vlerësuar me 18 pikë dhe është radhitur i 19-ti në listë, ndërsa në konkursin e kaluar ishte vlerësuar me 24.8 pikë dhe ishte radhitur i 3-ti.

Kandidati Sejdi Rexhepi, sipas Komisionit aktual, është vlerësuar me 21 pikë dhe është radhitur i 14-ti, ndërsa në konkursin e kaluar ishte radhitur i 8-ti dhe ishte vlerësuar me 20.5 pikë. Kandidati Neron Berisha, sipas Komisionit aktual, është vlerësuar me 20 pikë, dhe është radhitur i 15-ti, ndërsa në konkursin e kaluar ai ishte vlerësuar me 19.3 pikë dhe ishte radhitur i 11-ti, duke hyrë në listën prej 12 kandidatëve që ka shkuar në Kuvendin e Kosovës.

Ndërsa kandidati Nebih Zariqi nga Komisioni aktual është vlerësuar më shumë se nga komisioni i kaluar. Zariqi nga Komisioni aktual është vlerësuar me 28 pikë dhe është radhitur i 4-ti, ndërsa nga Komisioni i kaluar ai është vlerësuar me 20.3 pikë dhe ishte radhitur si kandidati i 9-ti me më shumë pikë.

Kuvendi i Kosovës i ka zgjedhur tre drejtorë të bordit të KOSTT. Kandidatët më të votuar në seancën e Kuvendit të Kosovës kanë qenë Jeton Mehmeti, Arben Dodaj² dhe Nebih Zariqi³. Edhe pse në seancë ishte votuar ndaras për gra e ndaras për burra, por as përmes kësaj mënyre të votimit nuk doli asnjë grua që të merrte votat e nevojshme për t'u emëruar në bordin e KOSTT.

2.2. BORDI I RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS

Konkursi për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) është hapur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Komisioni për përzgjedhjen e e kandidatëve nga radhët e komunitetit shqiptar, serb dhe komuniteteve tjera është përbërë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës: Doruntinë Maloku (LDK), kryetare e komisionit; Arbreshë Kryeziu - Hyseni (LVV), Albert Kinolli (PREBK), Valon Ramadani (LVV), Agon Bashuta (LVV), Blerta Deliu - Kodra (PDK), Mërgim Lushtaku (PDK), Rasim Selmanaj (AAK), Slavko Simic (LS) dhe Ilir Ferati (LDK).

Ky konkurs nuk është asistuar nga kompania angleze, BDO, por është monitoruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN).

Në këtë konkurs për dy ditë janë intervistuar 32 kandidatë për anëtarë të bordit të RTK-së. Gjatë intervistimit, kandidatëve u janë bërë shumë nën-pyetje apo në rastet e caktuara duke mos i bërë asnjë nënpyetje. Në të dy rastet është diskriminim, sepse ndonjë kandidat është pyetur më shumë se të tjerët dhe kjo mund të interpretohet në dy mënyra: ai ka pasur më shumë mundësi të tregojë aftësitë e tij apo e kundërta, i janë bërë më shumë pyetje në mënyrë që të reflektojnë që i njëjti është i papërgatitur.

Në raste të caktuara, kandidatët janë pyetur për çështje që nuk bien në kompetencat e bordit të RTK-së, për çfarë kanë kandiduar ata. Një gjë e tillë bën që shumë prej kandidatëve të gabojnë dhe të përgjigjen edhe për çështje që nuk janë kompetencë e tyre.

Po ashtu, as kohëzgjatja e intervistave të kandidatëve nuk ka qenë e njëjtë, disa nga intervistat kanë zgjatur deri në 30 minuta e disa deri në gjysmë ore, por ka pasur të tjera që nuk kanë zgjatur më shumë se 10 minuta.

Kuvendi i Kosovës në fund ka përzgjedhur për anëtarë të bordit disa prej kandidatëve që kanë hyrë në rrethin e ngushtë, mirëpo kishin më së paku pikë. Ndërkohë, kandidatët me më shumë pikë nuk kanë marrë vota të mjaftueshme për t'u zgjedhur në bordin e RTK-së.

² <https://kallxo.com/lajm/zgjedhen-dy-drejto-re-bordit-te-kostt-it/>

³ <https://kallxo.com/lajm/kuvendi-e-zgjedh-edhe-drejtorin-e-trete-te-bordit-te-kostt-it/>

2.3. AVOKATI I POPULLIT

Konkursi për Avokatin e Popullit është shpallur nga Kuvendi i Kosovës më 26 maj 2020. Konkursi nuk ishte zhvilluar me asistencën e BDO-së dhe i njëjti ishte përcjellë me disa mangësi. Kuvendi i Kosovës, përkundër zotimit, nuk ka ofruar qasje në monitorim të plotë të procesit të rekrutimit për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit.

Procesi i rekrutimit të kandidatëve për Avokatin e Popullit nuk ka qenë transparent, pasi monitoruesi i BIRN-it nuk është lejuar në pjesën e vlerësimit të kandidatëve të intervistuar, pjesës kryesore të secilit proces të rekrutimit. Komisioni Vlerësues ka vendosur që poentimin e kandidatëve të bëjë vetëm në fund të procesit, pra kur janë intervistuar të gjithë kandidatët. Komisioni ka larguar monitoruesin e BIRN nga salla, i cili nuk është lejuar të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit të kandidatëve

Nga ana e Komisionit pas përfundimit të intervistave nuk u dha asnjë detaj për formën apo mënyrën e vlerësimit të kandidatëve. Asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk ka dhënë sqarime se cila do të jetë forma e vlerësimit, a i kanë vlerësuar secilin kandidat pas secilës intervistës, apo në çfarë forme do të bëhet mbledhja e pikëve të dhëna. Përveç vlerësimit sekret, anëtarët e Komisionit vlerësues nuk kanë mbajtur shënime për performancën e kandidatëve të intervistuar. BIRN ka vërejtur se anëtarët e panelit në shumicën e rasteve nuk kanë mbajtur shënime pas përgjigjes së kandidatit apo as edhe pas përfundimit të intervistës kur kandidati largohej nga salla.

Edona Hajrullahu, Naim Qelaj dhe Xhavit Shala ishin tre kandidatët që janë dërguar në Kuvendin e Kosovës për votim për të marrë detyrën e Avokatit të Popullit⁴. Me 69 vota për, 5 vota kundër dhe 3 abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë zgjedhur Naim Qelajn⁵ si Avokat të Popullit.

2.4. LAJTHITJA E KUVENDIT: NJERIU I PDK-SË NË KPM

Kuvendi i Kosovës e ka zgjedhur Granit Musliun anëtar të KPM-së, së bashku me Xhevat Latifin dhe Azdra Deshiq. KPM-ja është institucion kushtetues dhe anëtarë të saj nuk mund të jenë personat që në 2 vitet e fundit kanë qenë anëtarë të organit udhëheqës të një partie politike. Por, Granit Musliu, ish-nënkryetar i Rinisë Demokratike të Kosovës në Skenderaj, është zgjedhur anëtar i Komisionit të Pavarur të Mediave⁶. Musliu ka qenë anëtar edhe i Komisionit zgjedhor në zgjedhjet e brendshme të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) të mbajtura në fund të vitit 2018 dhe ka qenë aktiv në politikë duke marrë pjesë në shumë takime të PDK-së deri në vitin 2020.


BIRN e ka monitoruar këtë konkurs, mirëpo gjatë intervistimit nuk është përmendur asnjëherë se një nga kandidatët kishte të kaluar të lidhur me një parti politike. Intervistimi i kandidatëve për anëtarë të KPM-së ka filluar më 5 tetor 2020 në Kuvendin e Kosovës. Një pjesë e kandidatëve është intervistuar edhe më 6 tetor 2020. Në intervistim janë ftuar 14 kandidatë. Ftesës i janë përgjigjur 13 kandidatë, ndërsa një nuk mori pjesë në intervistim.

⁴ <https://kallxo.com/lajm/komisioni-parlamentar-votoi-listen-e-ngushte-prej-3-kandidateve-per-avokat-te-popullit/>

⁵ <https://kallxo.com/lajm/deputetet-votuan-avokatin-e-popullit/>

⁶ <https://kallxo.com/gjate/njeriu-i-pdk-se-emerohet-anetar-i-komisionit-te-pavarur-te-mediave/>

Tek pasi Kuvendi i Kosovës e ka zgjedhur në KPM, KALLXO.com ka pranuar raportime se njëri nga anëtarët e zgjedhur, Granit Musliu, kishte qenë aktiv në politikë. KALLXO.com ka hulumtuar dhe ka arritur të faktojë se Musliu ishte pjesë e Rinisë Demoraktike të Kosovës, ishte pjesë e Komisionit zgjedhor për zgjedhjet në parti që janë mbajtur në fund të vitit 2018, si dhe kishte marrë pjesë në takimet e brendshme të PDK-së edhe gjatë vitit 2020.



Granit Musliu është zgjedhur nënkryetar i Rinisë Demokratike të Kosovës në muajin maj të vitit 2018. Musliu ka thënë se ka dhënë dorëheqje nga pozita në Rininë Demokratike para më shumë se 2 viteve. BIRN ka kërkuar nga Musliu dëshmi për dorëheqjen e tij nga PDK, por ai nuk ka dërguar asnjë dokument dhe as nuk është përgjigjur në pyetjet shtesë të dërguara.

Pas raportimit, kryesuesi i Komisionit ad-hoc, deputeti Valon Ramadani, ka thënë se nuk kanë qenë në dijeni për të kaluarën politike të Granit Musliut. Ai ka thënë se kandidati Musliu nuk e ka njoftuar Komisionin për të kaluarën politike, përkundër që ka qenë i obliguar. Në Komisionin Parlamentar për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media⁷ është kërkuar shkarkimi i Musliut.

Nëpër konkurset publike të hapura për anëtarë të bordeve dhe menaxhmentit të institucioneve të ndryshme në Kosovë, kandidatët obligohen të nënshkruajnë "deklaratën nën betim" në të cilën ata duhet të deklarojnë pavarësinë e tyre. Por, kjo nuk është aplikuar fare për këtë konkurs, përkundër faktit që ligji kërkon që personat të mos kenë të kaluar politike. Kjo ishte konfirmuar edhe nga deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, e cila ka qenë pjesë e Komisionit për zgjedhjen e anëtarëve të KPM-së.

Përveç Valon Ramadani dhe Ganimete Musliut, pjesë e Komisionit kanë qenë edhe Besa Gaxherri, Slavko Simic, Lirije Kajtazi, Rezarta Krasniqi, Arbresha Kryeziu, Floretë Zejnullahu, Rasim Selmanaj, Agon Batusha dhe Fikrim Damka.

Sa i përket nenit 12 të Ligjit për KPM-së ku thuhet se nuk mund të zgjidhet anëtar i Komisionit të Pavarur të Mediave personi i cili është pjesëtar i organit udhëheqës të një partie politike apo personat që kanë qenë në këto pozita gjatë dy viteve të fundit, deputetja Musliu ka thënë se në bazë të statutit të PDK-së, Rinia Demokratike e Kosovës nuk është organ udhëheqës.

KPM-ja është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale. KPM po ashtu licencon transmetuesit publikë e privatë dhe i ripërtërin licencat, duke u dhënë subjekteve të autorizuara të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.

⁷ <https://kallxo.com/lajm/pas-raportimit-te-kallxo-com-kerkohet-shkarkimi-i-njeriut-te-pdk-se-ne-kpm/>

2.5. KRYESHEFI EKZEKUTIV I SEKRETARIATIT TË KQZ-SË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka zgjedhur Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit në një listë prej 9 kandidatëve përmes një vlerësimi jotransparent dhe sekret. Vlerësimi për gjithë procesin e rekrutimit për pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së duhet të ndahet në dy pjesë, procesi i intervistimit dhe vlerësimi i kandidatëve të intervistuar.

Pjesa më e dobët e këtij procesi të rekrutimit ka qenë vlerësimi i kandidatëve nga ana e anëtarëve të Komisionit vlerësues. Vlerësimi është bërë nga secili anëtar i Panelit, të cilët kanë plotësuar nga një formular për secilin kandidat të intervistuar, por nuk kanë qenë të obliguar të shkruajnë edhe emrin e tyre. Kjo ka bërë që vetëm një numër i kufizuar i anëtarëve të Komisionit vlerësues t'i nënshkruajnë dokumentet e vlerësimit, ndërsa pjesa më e madhe nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Pikët e dhëna nga anëtarët e Komisionit për secilin kandidat janë lexuar nga një person i personelit të KQZ-së pa treguar se cili anëtar i Komisionit i ka dhënë ato pikë.

Kjo mënyrë e vlerësimit ka nxjerrë edhe rezultate që nuk kanë qenë objektive, sidomos për dy kandidatët më të poentuar. Dallimi në pikët e dhëna për të njëjtin kandidat nga anëtarë të ndryshëm të Panelit shkon deri nga 25 pikë deri në 29 pikë, nga 30 pikë sa ka qenë dallimi në mes të pikëve maksimale dhe minimale (70 deri në 100 pikë).

Kandidati Yll Buleshkaj, nga 4 anëtarë të Panelit është vlerësuar me nga 100 pikë kurse nga tre anëtarë të tjerë me nga 73 dhe 75 pikë (2 dhe 3 pikë më shumë se vlerësimi minimal). Dallime të tilla ka pasur edhe te kandidati Burim Ahmetaj. I njëjti nga tre anëtarë të Panelit është vlerësuar me nga 100 pikë kurse nga një anëtar i Panelit me 71 pikë, një më shumë se vlerësimi minimal. Kurse vlerësimet prej 100 pikëve i janë afruar edhe dy kandidatët e tjerë, Nexhmedin Hyseni (që është pjesë e Sekretariatit të KQZ-së) dhe Miran Zeneli, që është pjesë e KPMSHC-së.

Kandidati	Anëtarët e Komisionit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	Tot	Tot/11
Burim Ahmetaj	Vlerësimi	100	99	83	80	78	86	100	93	99	71	100	989	89.9
Yll Buleshkaj	Vlerësimi	75	82	97	100	100	98	74	100	73	100	75	974	88.5

Një mënyrë e tillë e poentimit dhe vlerësimit është në kundërshtim të plotë me praktikën e vendosura nga ekspertët britanikë nga kompania BDO, që janë duke ofruar asistencë institucioneve të Kosovës. Në konkurset që janë asistuar nga ekspertët britanikë, vlerësimi është transparent dhe bëhen publike pikët e dhëna për secilën përgjigje të secilit kandidat.

Përveç kësaj, anëtarët e komisioneve (paneleve) vlerësuese janë të obliguar që t'i arsyetojnë pikët e dhëna për kandidatët, sidomos në rastet kur ka diskrepancë me anëtarët e tjerë, por kjo nuk ka ndodhur në këtë konkursin për kryeshef të Sekretariatit të KQZ-së.

Një çështje tjetër që është ngritur nga anëtarët e Komisionit vlerësues ka qenë ndërrimi i rregullores pasi që është hapur konkursi për këtë pozitë. Në fillim të takimit të Panelit të KQZ-së, anëtari nga Lëvizja Vetëvendosje, Sami Kurteshi, përmendi që KQZ e ka ndërruar rregulloren pas hapjes së konkursit dhe paraqitjes së kandidatëve për pozitën e KE të KQZ-së, për shkak të mosmarrëveshjeve për themelimin të Komisionit përzgjedhës për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së.

Sipas paragrafit 3.2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2012 "Paneli Intervistues përbëhet nga pesë (5) anëtarë të zgjedhur me vendim të KQZ-së, duke e respektuar përfaqësimin e komuniteteve, i cili ndërmerr të gjitha veprimet lidhur me hartimin e listës së shkurtër të kandidatëve për pozitën e KE-së. Kryesuesi i Panelit Intervistues zgjedhet nga ana e panelistëve." Ndërsa, KQZ këtë nen e ka ndryshuar në atë mënyrë që pjesë e Komisionit vlerësues janë të gjithë anëtarët e KQZ-së: "Paneli intervistues përbëhet nga të gjithë anëtarët (11) e Komisionit, i cili ndërmerr të gjitha veprimet lidhur me hartimin e listës së ngushtë të kandidatëve të KE-së/Zv-KE-së/SKQZ-së, Drejtorit Ekzekutiv të ZRPPC-së dhe Zëdhënësit për Informim, në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë udhëzim administrativ. Panelin e kryeson Kryesuesi i KQZ-së".

Pas intervistimit të disa prej kandidatëve, anëtarët e Komisionit vlerësues kanë bërë komente për përgjigjet e dhëna. Komentime të tilla e cenojnë autonominë e anëtarëve të Komisionit dhe mund të ndikojnë në vlerësimet që ata i bëjnë për një kandidat.

Paneli vlerësues është përbërë nga 11 anëtarët e KQZ-së: Valdete Daka, Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniç, Artan Asllani, Nenad Rikalo, Cemal Kurtisi. Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së është zgjedhur Burim Ahmetaj.

2.6. Anëtarët e KPMSHC-së

Katër nga pesë anëtarët e përzgjedhur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës⁸ (KPMSHC) nga ana e Kuvendit të Kosovës kishin marrë dritën e gjelbër edhe nga ekspertët britanikë si kandidatë të emërueshëm. Vetëm për njërin nga anëtarët që është zgjedhur nga Kuvendi në këtë Këshill, ekspertët britanikë kanë vlerësuar se nuk i plotëson kushtet për emërim përkatësisht nuk është i emërueshëm.

⁸ <https://kallxo.com/punesimet/kuvendi-zgjedh-anetaret-e-keshillit-mbikqyres-te-sherbimit-civil/>

Kandidatët e përzgjedhur për KPMSHC janë: Ardita Haxhinikaj-Demi, Malësore Gashi-Bajraktari, Arben Mehmeti, Jeton Koca dhe Eshref Shabani. Anëtari i përzgjedhur i Këshillit, Arben Mehmeti, në një postim në Facebook e ka pranuar se deri tash kishte post në Lidhjen Demokratike të Kosovës në Gjilan.

Malësore Gashi-Bajraktari kishte marrë 25.1 pikë nga Komisioni ad-hoc parlamentar dhe ishte renditur e pesta, por në listën e BDO-së (ekspertëve britanikë) nuk ishte në mesin e kandidatëve të emërueshëm për këtë pozitë.

Përveç Gashi-Bajraktarit, Komisioni vendor i përbërë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës kishte çuar në seancë edhe tre kandidatë të tjerë që për ekspertët britanikë nuk ishin të emërueshëm, por ata nuk kanë arritur të marrin vota të mjaftueshme për t'u zgjedhur në Këshill. Mërgim Himaj, si kandidati më i poentuar prej Komisionit vendor, nuk figuron në listën e të kualifikuarve të BDO-së, ashtu si edhe Malësore Gashi-Bajraktari, Agron Behrami dhe Alban Sutaj.


BDO-ja, kompania angleze e angazhuar nga Ambasada Britanike për t'i ofruar asistencë institucioneve në rekrutim, i ka përzgjedhur si të kualifikuar kandidatët, Zylë Gojnovci dhe Lulzim Aliaj, por këta dy kandidatë nuk kanë shkuar fare në seancë për votim pasi Komisioni vendor nuk i ka futur në listën e 10 kandidatëve të suksesshëm.

Anëtarët e tjerë të Këshillit të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës kanë qenë edhe në listën e personave të emërueshëm të ekspertëve britanikë, por që ka dalluar vetëm renditja e tyre.

2.7. TRI DËSHTIMET PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI

Në seancën e 14 gushtit, Kuvendi i Kosovës për të tretën herë me radhë ka dështuar⁹ në përzgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Për këtë pozitë fillimisht kishin aplikuar 12 persona por pas shqyrtimit të aplikacioneve në garë të ngushtë kishin hyrë 5 persona. Komisioni Parlamentar për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes i kishte rekomanduar Kuvendit tre kandidatë: Bujar Sadikun, Krenare Sogojeva-Dermakun dhe Muharrem Mustafën.

Konkursi ishte asistuar nga ekspertët britanikë të BDO-së, të cilët kishin vlerësuar se dy nga kandidatët kishin qenë të emrueshëm: Krenare Sogojeva-Dërmaku dhe Bujar Sadiku. Këta dy persona kishin marrë pëlqimin nga Ambasada Britanike si kandidatët më të suksesshëm për emërim në krye të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, prandaj i kishin propozuar Kuvendit të Kosovës që njërin prej tyre ta emëronin si Komisioner. Përkundër rekomandimeve të Ambasadës Britanike, Kuvendi i Kosovës edhe për të tretën herë radhazi ka dështuar në përzgjedhjen e Komisionerit për Informim dhe Privatësi.



Dështimi i konkursit për të tretën herë radhazi bëri që Ambasada Britanike të reagojë dhe të shprehë zhgënjim. Madje, Ambasada Britanike ka njoftuar se ekspertët britanikë të BDO-së janë tërhequr nga procesi i rekrutimit për këtë pozitë. Ambasada në reagim kishte thënë se nuk do t'i çojnë dëm paratë e tatimpaguesve britanikë në proceset e përsëritura që ishin transparente dhe të zhvilluara me rregull, dhe që nxorën kandidatë që i plotësojnë kushtet për emërim.


Ky proces i rekrutimit në të tri herët është zhvilluar nën mbështetjen e Ambasadës Britanike si dhe nën monitorimin e organizatës BIRN si dhe disa organizatave të tjera.

⁹ <https://kallxo.com/lajm/si-deshtoi-per-te-treten-herë-radhazi-konkursi-per-emerimin-e-komisionerit-per-informim-dhe-privatesi/>

3. VITI I SHKARKIMEVE

Në vitin 2020 në Kosovë janë ndërruar tri qeveri të udhëhequra nga kryeministra që vinin nga tri parti të ndryshme: Ramush Haradinaj, Albin Kurti dhe Avdullah Hoti. Qeveria Kurti, e cila ka ardhur në pushtet më 3 shkurt 2020¹⁰, disa ditë pasi mori pushtetin filloi shkarkimin e bordeve nëpër ndërmarrjet publike të emëruara gjatë qeverisë Haradinaj dhe që kishin lidhje me tri partitë në koalicion: PDK, AAK dhe Nisma Socialdemokrate.

Qeveria Kurti shkarkoi 11 borde të ndërmarrjeve publike të cilat i zëvendësoi me borde të përkohshme. Qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti u rrëzua 50 ditë më vonë, më 25 mars 2020. Edhe Qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti, e cila e pasoi Qeverinë Kurti, vazhdoi me shkarkimet e anëtarëve të bordeve, të cilët i kishte emëruar paraardhësi i tij, Albin Kurti. Edhe Hoti, njëjtë si paraardhësit e tij, vazhdoi me emërimet politike nëpër bordet e përkohshme të këtyre ndërmarrjeve publike. Madje vetëm gjatë 3 muajve, Hoti ka emëruar dy borde të ndryshme në Koorporatën Energjetike të Kosovës (KEK).



¹⁰ <https://kallxo.com/lajm/betohet-qeveria-e-re-e-kosoves/>

3.1. EMËRIMET POLITIKE TË QEVERISË KURTI

Pas ardhjes në pushtet të Qeverisë Kurti, bordi i parë që u shkarkua ishte ai i ndërmarrjes publike, Telekom i Kosovës. Qeveria Kurti u shkarkua nga Kuvendi i Kosovës pas votës së suksesshme të mosbesimit. Qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti, edhe pse ishte në detyrë, shkarkoi Bordin drejtues të Shërbimit Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), për arsye se nuk i ka përbushur detyrat dhe përgjegjësitë e rëndësishme të përcaktuara me Statutin e ShSKUK-së dhe ka dështuar në arritjen e objektivave. Me po të njëjtin vendim atëherë Qeveria në detyrë e ka emëruar Bordin e ri në përbërje prej shtatë anëtarësh.

Pjesë e këtij bordi ishte bërë edhe Mirsad Shkreta, këshilltar i ish-ministrit¹¹ të Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili vjen nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje¹². Shkreta gjithashtu në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 ka qenë kandidat për deputet të Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje. Në këto zgjedhje Shkreta i kishte siguruar 3,387 vota, duke mos arritur të bëhet deputet i LVV-së.

Në prill 2020, Kurti shkarkoi bordin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" i cili ishte ndarë¹³ mes AAK-së, Nisma-s dhe PDK-së. Qeveria Kurti menjëherë emëroi bordin e ri të përkohshëm të kësaj kompanie publike. Të emëruarit në bordin e ri ishin Mentor Hyseni - kryesues; Hajrie Morina - anëtare, Idriz Maliqi - anëtar dhe Seat Bilibani - anëtar.

Mentor Hyseni¹⁴ në zgjedhjet e fundit nacionale ka qenë kandidat për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa ishte anëtarësuar në këtë parti në gusht të vitit 2019. Kurse Seat Bilibani¹⁵ ishte kandidat për deputet në vitin 2017, nga radhët e partisë së ish-ministres së Administrimit të Pushtetit Lokal (MPL) në Qeverinë Haradinaj, Emilija Rexhepi.

Në mbledhjen e 2 prillit, Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Albin Kurti emëroi bordin e përkohshëm të Postës së Kosovës. BIRN ka zbuluar se kryesuesi i bordit, Mentor Arifaj¹⁶, i kishte dhënë një donacion prej 1 mijë euro partisë së Albin Kurtit në zgjedhjet e fundit të 6 tetorit 2019 ku LVV doli e para. Disa muaj më vonë, Qeveria e Kurti ka emëruar donatorin e saj si kryesues në bordin e përkohshëm të Postës së Kosovës.

Në mesin e të emëruarve nga Qeveria Kurti ishte edhe Abdullah Lala¹⁷, si anëtar i bordit në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos". Lala është pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje në degën e kësaj partie në Podujevë. Këtë e ka konfirmuar edhe vet Lala për BIRN. Përveç Lalës, në bordin e Ndërmarrjes Publike "Infrakos" ishte emëruar edhe Artan Dërmaku¹⁸, i cili po ashtu është pjesë e partisë Lëvizja Vetëvendosje. Dërmaku ishte prezantuar disa muaj më parë nga kreu i LVV-së, Albin Kurti, si anëtari më i ri i partisë.

¹¹ <https://kallxo.com/lajm/te-punesuarit-ne-kabinetin-e-ministrit-arben-vitia/>

¹² <https://kallxo.com/lajm/ish-kandidati-per-deputet-i-vetevendosjes-emerohet-anetar-bordi-i-shskuk-se/>

¹³ <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/pdk-aak-e-nisma-e-ndajne-bordin-e-ujesjellesit/>

¹⁴ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-kurti-emeron-perkohesisht-ne-krje-te-bordit-te-ujesjellesit-anetarin-e-lvv-se/>

¹⁵ <https://kallxo.com/lajm/i-zgjedhuri-ne-bordin-e-kru-prishtina-ish-kandidat-per-deputet-nga-partia-e-ministres-emilija-rexhepi/>

¹⁶ <https://kallxo.com/lajm/donatori-i-vetevendosjes-u-emerau-kryesues-i-bordit-te-postes/>

¹⁷ <https://kallxo.com/lajm/edhe-nje-anetar-tjeter-i-lvv-se-emerohet-ne-bordin-e-perkohshem-te-infrakosit/>

¹⁸ <https://kallxo.com/lajm/ministria-hajdari-konfirmon-qe-anetari-i-bordit-ne-infrakos-eshte-i-lvv-se/>

3.2. EMËRIMET POLITIKE TË QEVERISË HOTI

Pas formimit të Qeverisë Hoti, bordet e përkohshme të emëruara nga Qeveria Kurti ishin në mes të konkurseve për zgjedhjen e menaxhmenteve të ndërmarrjeve publike. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi disa herë u kishte kërkuar që të anulonin konkurset për kryeshef e pozita tjera të larta. Vetëm Bordi i Postës së Kosovës kishte vepruar sipas kërkesës së Qeverisë Hoti, duke i anuluar konkurset, ndërsa ndërmarrjet tjera nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Pas këtij refuzimi, në muajin gusht, Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Avdullah Hoti shkarkoi bordet e katër ndërmarrjeve publike të cilat ishin emëruar nga ish-kryeministri, Albin Kurti. U mor vendim për shkarkimin¹⁹ e bordeve të përkohshme të Kompanisë Rajonale të Ujësjesit KRU "Prishtina", Ndërmarrjes Publike Qendrore NPH "Ibër – Lepenc", Ndërmarrjes Publike "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës – KEK", dhe Ndërmarrjes Publike KRU "Hidroregjioni Jugor" - Prizren. Qeveria në këtë mbledhje pas shkarkimit të këtyre bordeve të emëruara nga Qeveria Kurti, mënjëherë kishte emëruar bordet e përkohshme të këtyre katër ndërmarrjeve publike.

Edhe pse në gusht ishte emëruar bordi i KEK-ut, tre muaj më vonë, Hoti shkarkoi bordin që e kishte emëruar vet, dhe emëroi një bord të ri. Qeveria e Kosovës e ka shkarkuar Bordin e përkohshëm të ndërmarrjes KEK, duke e emëruar një bord të ri të përkohshëm. Kryesues i këtij bordi është zgjedhur Musa Misini²⁰, i cili ka qenë kandidat i LDK-së për deputet në zgjedhjet e vitit 2014 dhe ish-kryetar i Komunës së Vitisë nga radhët e LDK-së. Bordi i ri i KEK-ut, gjithashtu përbëhet nga drejtorët, Petrit Ibraj, Fatime Grajçevci dhe Fadil Hoxha.

Në tetor, Qeveria e Kosovës emëroi bordet e përkohshme të ndërmarrjeve²¹, Infrakos, Posta e Kosovës si dhe ndërmarrjes publike "Trepça". Këto emërimet janë bërë me arsyetim se bordeve të parakohshme u ka skaduar mandati. U mor vendim që në Bordin e përkohshëm të ndërmarrjes "Trepça" ta rikthejë si anëtar, Esat Pecin²², i cili ishte shkarkuar nga Qeveria Kurti. Esat Peci ka qenë asamblist AAK-së në Mitrovicë, dhe ishte futur në Bordin e Trepçës pikërisht në kohën e Qeverisë Haradinaj. Ndërsa në një prononcim të mëherëshëm për BIRN, Peci kishte mohuar të jetë pjesë e AAK-së. BIRN kishte raportuar se emërimi i Pecit në Bordin e Ndërmarrjes Trepça ishte bërë në kundërshtim me Ligjin për Trepçën, i cili ndalon që në Bordin Mbikëqyrës të gjigantit metalurgjik të emërohen anëtarë të partive politike e njerëz që kanë poste partiake

Në mbledhjen e Qeverisë Hoti, Fadil Aliu – Hertica, Leonard Shabani dhe Elda Maloku u emëruan në bordin e përkohshëm të Postës së Kosovës. Fadil Aliu – Hertica²³ ka qenë kandidat për deputet nga radhët e LDK-së në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Aliu kishte mbajtur numrin 91 në listën zgjedhore të kandidatëve për deputetë të LDK-së. Aliu kishte grumbulluar 2,841 vota në zgjedhjet e 11 qershorit 2017.

Kurse anëtarja tjetër e bordit të Postës së Kosovës, Elda Maloku²⁴ është aktiviste e Nismës Socialdemokrate. Maloku është parë në disa prej tubimeve që janë organizuar nga Nisma Socialdemokrate, e cila është pjesë e koalicionit qeverisës. BIRN ka kontaktuar Malokun por ajo ka refuzuar që të përgjigjet në pyetjet e parashtruara.

¹⁹ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-hoti-shkarkon-bordet-e-emeruara-nga-qeveria-kurti/>

²⁰ <https://kallxo.com/lajm/anelari-i-ldk-se-emerohet-kryesues-i-bordit-te-kek-ut/>

²¹ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-emeron-bordet-e-perkohshme-te-infrakos-it-trepces-si-dhe-postes-se-kosoves/>

²² <https://kallxo.com/lajm/qeveria-hoti-rikthen-njeriun-e-aak-se-ne-bordin-e-trepces/>

²³ <https://kallxo.com/lajm/ish-kandidati-i-ldk-se-per-deputet-emerohet-ne-bordin-e-postes-se-kosoves/>

²⁴ <https://kallxo.com/lajm/aktivistja-e-nismes-socialdemokrate-emerohet-anetare-e-bordit-te-postes-se-kosoves/>

Më 19 tetor 2020, Qeveria Hoti e ka emëruar Brahim Selimajn, Sead Thaçin, Avni Kajdomçajn dhe Sanja Lazareviqin në bordin e përkohshëm të ndërmarrjes "Hekurudhat e Kosovës – Infrakos". zBrahim Selimaj²⁵ ka qenë kandidat për deputet nga radhët e LDK-së në zgjedhjet e parakohshme që janë mbajtur në vitin 2019. Selimaj ka mbajtur numrin 65 në listën zgjedhore të kandidatëve për deputetë të LDK-së. Ai kishte grumbulluar 5,565 vota në zgjedhjet e 6 tetorit. BIRN ka siguruar CV-në e Selimajt. Ai në CV ka shkruar që ka qenë themelues i LDK-së në vitin 1989, nënkryetar i nëndegës "7 Shtatori" për tri mandate, anëtar i Kryesisë së LDK-së, dega në Pejë, nga viti 1999 deri në vitin 2019, kryetar i nëndegës "7 Shtatori" nga viti 2014 deri në vitin 2019. Po ashtu, Selimaj ka shkruar që përveç në vitin 2019, ai ka qenë kandidat i LDK-së për deputet edhe në vitin 2014. Ai po ashtu ka qenë kryetar i Shoqatës së Ndërtuesve dhe prodhuesve të materialit ndërtimor nga viti 2014 deri në vitin 2018.

Kurse Enver Gashi²⁶, vëllai i kryetarit të Obiliqit, Xhafer Gashi dhe njëkohësisht asamblisti i AAK-së në Kuvendin Komunal të Obiliqit, në fillim të muajit shtator është emëruar ushtrues detyre i zv.drejtorit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Emërimi i tij në këtë pozitë nga ana e Bordit të KEK-ut është bërë në kundërshtim me interpretimin që e ka dhënë Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik për Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Gashi është emëruar disa muaj pasi bordi i përkohshëm i emëruar nga Qeveria Kurti, e kishte shkarkuar Nysret Kelmendin nga pozita e zv.drejtorit të KEK-ut. Në të njëjtën kohë ishte shkarkuar edhe Njazi Thaçin nga pozita e drejtorit të kësaj ndërmarrjeje, i cili është edhe kushëri²⁷ i ish-Presidentit Hashim Thaçi.

3.3. ANULIMI KUNDËRTHËNËS I KONKURSIT PËR KRYESHEF TË KRU "PRISHTINA"

Për dallim nga bordet e ndërmarrjeve tjera, bordi i përkohshëm i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina" kishte vepruar më shpejt, duke i kryer të gjitha procedurat për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv. Konkursi është anuluar edhe pse bordi i përkohshëm i përbërë nga Mentor Hyseni – kryesues i bordit dhe tre anëtarët e tjerë – Seat Bilibani, Hajrie Morina dhe Idriz Maliqi kishte kryer të gjitha procedurat, nga shqyrtimi i aplikacioneve deri te përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Prishtina".

Por Fadil Abdullahu, kandidati i përzgjedhur për të qenë Kryeshef Ekzekutiv i KRU Prishtina, nuk do të mbajë këtë pozitë për shkak se konkursi është anuluar 6 ditë pas intervistimit të tij dhe përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm.

Mënjeherë kishte reaguar Qeveria Hoti, duke e shkarkuar bordin e udhëhequr nga Hyseni dhe duke e emëruar bordin e ri, të përbërë nga: Labinot Dedushi – kryesues i bordit dhe tre anëtarët e tjerë - Agim Miftari, Arlind Haziri dhe Linda Spahiu. Ky bord, i emëruar nga Qeveria Hoti më 3 gusht, ka anuluar konkursin e shpallur për pozita të larta nga bordi i përkohshëm i emëruar nga Qeveria Kurti.

Zyra e Kryeministrit të Kosovës është duke zhvilluar procedura për përzgjedhjen e bordit të drejtorëve të ndërmarrjes KRU "Prishtina". Pas zgjedhjes së bordit pritet të shpallet konkursi për zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv. Deri në përzgjedhjen e kryeshefit të ri, ushtrues detyre në këtë pozitë do të jetë Sokol Xhafa.

²⁵ <https://kallxo.com/lajm/ish-kandidati-per-deputet-i-ldk-se-emerohet-ne-bordin-e-infrakos-it/>

²⁶ <https://kallxo.com/gjate/vellai-i-xhafer-gashit-dhe-asamblisti-i-aak-se-emerohet-u-d-i-zevendesdrejtorit-ne-kek/>

²⁷ <https://kallxo.com/shkurtyr/kusheriri-i-presidentit-hashim-thaci-ne-krye-te-kek-ut/>

Vlerësimet meritore në konkursin për kryeshef

Konkursi për kryeshef të ndërmarrjes KRU "Prishtina" ishte zhvilluar në një frymë konkurruese në mes të kandidatëve. Në fund, kandidati më i poentuar për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të ndërmarrjes ka qenë Fadil Abdullahu me një mesatare të pikëve prej 4.61 pikë. Pas tij janë radhitur UD i Kryeshefit Ekzekutiv të tanishëm, Sokol Xhafa, me 4.33 pikë kurse i treti është renditur Naser Rusinovci me 4.02 pikë.

Fillimisht bordi kishte rënë dakord që të përzgjidheshin tre kandidatët më të vlerësuar e më pas të vendosej se cili kandidat të rekomandohej për Kryeshef Ekzekutiv. Pasi u pa renditja e kandidatëve më të vlerësuar filloi diskutimi se për cilin do të vendosë bordi që të emërohet KE në KRU "Prishtina".

Anëtari i bordit, Idriz Maliqi, tha që është për kandidatin Fadil Abdullahu, për shkak se është më i poentuari nga të gjithë ndërsa Hyseni dhe Morina deklaruan se bordi ishte dakorduar që të përzgjedhin unanimisht njërin nga tre kandidatët më të vlerësuar.

Pas insistimit të anëtares së bordit Hajrie Morina, filloi një debat mes anëtarëve të bordit në lidhje me vlerësimin e kandidatit Sokol Xhafa nga anëtari i bordit, Idriz Maliqi. Atij iu kërkua që t'i argumentojë pikët që i ka vendosur Xhafës. Sipas anëtares së bordit Hajrie Morina, Xhafa kishte qenë shumë i mirë për një vlerësim kaq të ulët nga Maliqi.

Kandidati Sokol Xhafa është vlerësuar me 4.83 pikë nga Hajrie Morina, me 4.50 pikë nga Mentor Hyseni dhe me 3.66 nga Idriz Maliqi. Dallimi mes pikëve të Hajrie Morinës dhe Idriz Maliqit për kandidatin Sokol Xhafa është 1.17, dallimi mes pikëve të Mentor Hysenit dhe Idriz Maliqit është 0.84 ndërsa dallimi mes pikëve të Hajrie Morinës dhe Mentor Hysenit për kandidatin Sokol Xhafa është 0.33 pikë.

Hajrie Morina deklaroi që pikët e ulëta të Idriz Maliqit për Sokol Xhafën kanë ndikuar që i njëjti mos të jetë kandidati më i vlerësuar për kryeshef ekzekutiv.

Anëtari i bordit, Idriz Maliqi, kur i është kërkuar të argumentojë vlerësimin e tij për kandidatin Sokol Xhafa, ka dhënë argumente që kanë të bëjnë me punën e Xhafës në të kaluarën, para intervistës, dhe jo për ato që janë thënë gjatë intervistës.

Praktikë e BDO-së, kompanisë së angazhuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë, është që kandidatët të vlerësohen për përgjigjet gjatë intervistës për pozitën të cilën kanë konkurruar dhe jo të vlerësojnë atë që dinë nga më herët për kandidatët, për shkak se vlerësimi nuk është objektiv. Në fund u vendos që kandidati Fadil Abdullahu, i cili edhe ka dalë të jetë kandidati më i vlerësuar nga Paneli intervistues të emërohet Kryeshef Ekzekutiv në "KRU Prishtina".

Secili prej anëtarëve të Bordit – Panelit përzgjedhës, kanë mbajtur shënime për performancën e kandidatëve gjatë intervistës por kumtimi i pikëve për secilin kandidat nga tre anëtarët e Panelit përzgjedhës – Mentor Hyseni, Hajrie Morina dhe Idriz Maliqi, është bërë në fund të gjithë procesit të intervistimit. Pas çdo kandidati të intervistuar dhe një pauze 5 minutëshe, në sallë për intervistë ka ardhur kandidati tjetër për intervistë. Pra nuk është bërë vlerësimi pas secilit kandidat siç është edhe praktikë e BDO-së.

Pas përfundimit të intervistimit të kandidatëve, anëtarët e bordit, Hajrie Morina dhe Idriz Maliqi, ia kanë dërguar vlerësimin e tyre Mentor Hysenit, kryesuesit të bordit. Hyseni ka mbledhur vlerësimin e tij me ato të dy anëtarëve të tjerë të bordit, duke nxjerrë edhe vlerësimin përfundimtar dhe kandidatin më të poentuar nga paneli intervistues.

Gjatë intervistimit ka marrë pjesë edhe anëtari i bordit nga komuniteti boshnjak, Seat Bilibani, por i njëjti nuk ka parashtruar pyetje për asnjë kandidat. I njëjti nuk ka bërë as vlerësimin e tyre por ka marrë pjesë në diskutimin e bordit për vendimin përfundimtar për përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv të "KRU Prishtina".

3.4. KONKURSET E REJA PËR BORDE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Në muajin korrik, Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Avdullah Hoti ka hapur konkurs për borde të drejtorëve në 11 ndërmarrje publike. Shumica e këtyre ndërmarrjeve për të cilat ka hapur konkurs Qeveria Hoti, kanë pasur borde të përkohshme që ishin emëruar nga Qeveria Kurti.

Këto janë Ndërmarrjet Publike për të cilat Qeveria e Kosovës ka hapur konkurs për Bord të drejtorëve: Telekom i Kosovës; Posta e Kosovës; Korporata Elektroenergjetike e Kosovës; Bordit Mbikëqyrës i ndërmarrjes "Trepça"; NPH "Ibër-Lepenc"; Hekurudhat e Kosovës – InfraKos; Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Hidroregjioni Jugor" - Prizren; Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Prishtina" - Prishtinë; Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Radoniqi", - Gjakovë; Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Mitrovica" - Mitrovicë dhe Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Hidromorava" - Gjilan.

Procesi i rekrutimit nëpër këto ndërmarrje ende nuk ka përfunduar. Deri më tani, ka përfunduar faza e parë - hartimi i listës së ngushtë me kandidatët e suksesshëm që do të intervistohen. Për herë të parë në procese të tilla të rekrutimit është krijuar edhe Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në të cilën janë shqyrtuar ankesat e kandidatëve të eliminuar. Pas shqyrtimit të ankesave dhe njoftimin e kandidatëve me vendimin e Komisionit, do të fillojë edhe faza e intervistimit të kandidatëve për anëtarë të bordeve të 11 ndërmarrjeve publike.

Karakteristikë e këtyre konkurseve për anëtarë të bordeve ka qenë numri i madh i kandidatëve që kanë aplikuar për këto pozita. Në disa prej bordeve, numri i aplikantëve ka shkuar deri në rreth 200.

Pasi Zyra e Kryeministrit të Kosovës (ZKM) ka hapur konkurset për zgjedhjen e bordeve nëpër ndërmarrjet publike, BIRN ka dërguar disa rekomandime për verifikimin e listës së ngushtë të kandidatëve mbi pavarësinë e tyre para se të intervistohen. Komisioni Vlerësues për bordin e KEK-u ka kërkuar nga Sekretariati i KQZ-së informata për secilin/ën kandidat/e që i ka plotësuar kushtet për t'u thirrur në intervistë, nëse i njëjti/e njëjta ka qenë kandidat/e në zgjedhje lokale apo qendrore në 36 muajt e fundit, për të parë nëse kandidimi i tij/saj është në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

Duke u nisur nga përvojat e kaluara kur janë emëruar shumë persona që nuk kanë qenë të pavarur siç kërkohet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, BIRN ka kërkuar nga ZKM që të kërkojnë informacione nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Thesari i Shtetit për gjithë kandidatët, nëse kanë qenë kandidatë për ndonjë post politik apo kanë qenë të emëruar politikë. Përveç informacioneve nga Sekretariati i KQZ-së, për të parë nëse kandidatët për borde të ndërmarrjeve publike kanë qenë kandidatë në zgjedhjet lokale apo qendrore, BIRN ka rekomanduar që të kërkojnë informata edhe nga Thesari i Shtetit (MF) dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, nëse kandidatët për borde kanë mbajtur pozita politike nëpër institucionet ekzekutive, të cilët nuk kanë shkuar përmes zgjedhjeve por janë me emërim.

Në një përgjigje për kërkesën e BIRN, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është zotuar që do të kërkojë nga të gjitha komisionet vlerësuese që t'i zbatojnë rekomandimet e BIRN, në të gjitha proceset për zgjedhjen e bordeve. Një praktikë e tillë fillimisht ishte aplikuar gjatë përzgjedhjes së bordit të KEK-ut, një nga shumë konkurset që janë duke u zhvilluar nëpër ndërmarrjet publike.

Pas zbatimit të rekomandimit të BIRN, janë eliminuar nga gara për t'u bërë anëtarë të bordeve 20 persona. Këta kandidatë të eliminuar zakonisht kanë aplikuar në më shumë se një bord të ndërmarrjeve publike.

20 persona me të kaluar politike largohen nga gara për borde të Ndërmarrjeve Publike pas rekomandimit të BIRN-it

Konkurset janë duke u zhvilluar me asistencën e BDO-së, kompanisë britanike të angazhuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe, për të ofruar asistencë institucioneve të Kosovës në rekrutim të pozitive të larta drejtuese. BIRN është duke i monitoruar konkurset për borde të ndërmarrjeve publike.

BIRN vazhdimisht ka raportuar në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike që janë bërë në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Ligji për Ndërmarrjet Publike thotë se zyrtarët e lartë të ndërmarrjeve publike duhet të jenë të pavarur dhe se nuk mund të zgjidhen në ato pozita nëse në 36 muajt e fundit para aplikimit kanë qenë të emëruar politikë, zyrtarë të zgjedhur publikë apo kanë mbajtur pozita të rëndësishme në parti politike.

Emërimi i anëtarëve në bordet e ndërmarrjeve publike në Kosovë është një ndër proceset që vazhdimisht është kritikuar nga shoqëria civile në Kosovë, e së fundmi, edhe nga faktori ndërkombëtar²⁸.

²⁸ <https://kallxo.com/shkurt/politizimi-i-bordeve-qe-alarmoi-diplomatet-e-huaj-ne-kosove/>

4. PUNËSIMET ME TENDERË

Prokurimi është cilësuar si një prej sektorëve më të ndjeshëm ndaj korrupsionit. Përkundër shumë vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare e lokale për prani të korrupsionit në prokurim, ky sektor po proklamohet si zgjidhje për punësimet me kontrata mbi vepër. Nga 2 mijë deri në 4 mijë persona në vit janë punësuar me kontrata mbi vepër në kundërshtim me ligjin, pa konkurse ose në pozita të rregullta.

“Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit”, thuhet në nenin 12 të Ligjit për Shërbimin Civil. Kjo praktikë tashmë ka përfunduar. Nga fillimi i muajit korrik, rekrutimi i punëtorëve për shërbime të veçanta do të bëhet duke u bazuar në nenin 84 për Marrëveshjet për shërbime të veçanta të Ligjit për Zyrtarë Publik.

“Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik”, thuhet në ligjin e ri.

Pas hyrjes në fuqi të ligji të ri, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ka hartuar rregullat për prokurim të shërbimeve të veçanta, të cilat kanë hyrë në fuqi më 22 shtator 2020. Edhe pse rregullorja ka hyrë në fuqi në shtator, asaj nuk kanë mundur t'i referohen institucionet për punësim të stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta deri më 18 nëntor 2020, për shkak të problematikave që kanë dalë me paragrafin 3 të nenit 3 të Rregullores.

Në paragrafin 3 ishte kërkuar që personat fizikë të cilët aplikojnë duhet të pajisen me numra fiskalë. Sipas ATK-së, nëse të gjithë personat që aplikojnë për punë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta pajisen me numra fiskalë, atëherë në fund sistemi i ATK-së do të ngarkohet me shumë numra fiskalë të cilët do të mbesin fiktivë, për shkak se të gjithë nuk do të punësohen.

Si zgjidhje për këtë është zgjedhur që të gjithë personat që dëshirojnë të aplikojnë, mund ta bëjnë atë përmes regjistrimit në platformën E-prokurimi si EO-person fizik. Kështu më pas, vetëm personat që pranohen në punë do të pajisen me numra fiskalë nga ATK. “Për shërbime konsulente individuale mund të ofertojnë vetëm personat fizikë nga të cilët nuk kërkohet që të kenë biznes të regjistruar por personi fizik duhet të regjistrohet në platformë të prokurimit elektronik si EO - person fizik”, thuhet në paragrafin 3 të nenit 3 të Rregullores së re²⁹, e cila e ka shfuqizuar rregulloren e 22 shtatorit dhe ka hyrë në fuqi më 18 nëntor 2020.

²⁹ https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/439/Ndryshim_Plot

SI DO TË BËHET PUNËSIMI PËR SHËRBIME TË VEÇANTA?

Rregullat e hartuara nga KRPP aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta, të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë. Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit, janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por që nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka.

Ndryshe nga Ligji për Shërbimin Civil i cili ka lejuar që punësimi me marrëveshje për shërbime të veçanta apo kontrata mbi vepër të bëhej jo më gjatë se 6 muaj, me Ligjin për Zyrtarë Publikë, kohëzgjatja e kontratave do të jetë deri në 36 muaj. Procedura për rekrutim të stafit për shërbime të veçanta fillon me publikimin e njoftimit për kontratë në platformën elektronike, të përgatitur në përputhje me nenin 40-të të Ligjit të Prokurimit Publik dhe me ngarkimin e Dosjes së tenderit të miratuar nga KRPP.


Vlerësimi do të bëhet menjëherë duke marrë parasysh disa kritere, të tilla si: përvoja përkatëse e këshilltarit, cilësia e metodologjisë së propozuar, kualifikimi; dhe/ose transferimi i dijenisë, nëse kërkohet. Përvoja specifike do të vlerësohet nga 20 deri në 50, përshtatja e metodologjisë/planit të punës do të vlerësohet nga 20 deri në 50, kualifikimi nga 20 deri në 40 kurse transferimi i njohurisë (opsionale) 0-10.

“Pikët totale do të fitohen duke bashkuar pikët teknike dhe financiare. Notat e “kostos” duhet të përzgjidhen duke marr parasysh ndërlikueshmërinë e objektit të kontratës që duhet dhënë si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë. Rezultati i peshuar i propozimit financiar duhet të specifikohet në Dosje të Tenderit, dhe mund të jetë deri në 30 pikë”, theksohet në rregullat e KRPP-së.

NUMRI I MADH I KONTRATAVE MBI VEPËR

Sipas raportit vjetor të Auditimit vitit 2019, numri total i të angazhuarve përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, ishte 4,197. Krahasuar me numrin prej 2,618 në vitin 2018, ka pasur një rritje të këtyre të punësuarve për 1,579 kurse krahasuar me vitin 2017, kur ishin 2,929 kishte një rritje prej 1,268.

Rritja më e theksuar në vitin 2019 ishte te KQZ për 1,115 të cilët ishin angazhuar për procesin e zgjedhjeve të parakohshme për kryetar në komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019.



Sipas Ministrisë së Financave, 2,947 persona kanë qenë të angazhuar me kontrata mbi vepër në nivelin qendror kurse 1,250 në nivelin lokal.

Gjetjet kryesore të dala nga raportet individuale të auditimit për vitin 2019, sa i përket këtyre të angazhuarve ishin: angazhimi i tyre pa respektuar ndonjë procedurë të rekrutimit, siç kërkojnë rregullat ligjore, periudha e angazhimit të zyrtarëve më e gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, kontratat e lidhura për këto pozita ishin për pozita të rregullta, e jo për ekspertë të fushave përkatëse, për çka lejohet ky lloj angazhimi dhe vazhdimi i angazhimit të zyrtarëve me MSHV nga vitet paraprake.

5. KOSTO E PUNËSIMEVE JO-MERITORE

5.1. MONOPOLI ME DRITË TË DIELLIT

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) përbëhet nga 4 anëtarë, dy anëtarë janë zgjedhur në vitin 2018 dhe dy të tjerë janë zgjedhur në vitin 2016. Arsim Janova dhe Besim Sejfiqaj kanë qenë të angazhuar nga LDK dhe janë zgjedhur gjatë kohës kur qeverinë e ka udhëhequr Isa Mustafa. Izet Rushiti, i cili ka qenë kandidat për asamble të Komunës së Ferizajt nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Selman Hoti, janë emëruar në bord edhe pse nuk i kanë plotësuar kushtet për emërim, sipas vlerësimit të bërë nga kompania britanike, BDO.

BIRN e ka përcjellur nga afër aktivitetin e bordit të ZRRë-së duke raportuar për disa vendime kundërthënëse, por vendimi më i rëndësishëm është marrë më 27 nëntor 2019, për rritjen e sasisë së energjisë solare edhe për 20 megavat energji solare shtesë që do të përfitojë tarifa nxitëse, pra do të kenë të garantuar shitjen e energjisë së prodhuar me një çmim prej 85.5 euro për megavat.

Bordi kishte vendosur për të përkrahur prodhimin e energjisë solare përmes tarifave nxitëse përkundër faktit që kishte marrë rekomandime e argumente nga disa institucione se kjo mënyrë e përkrahjes nuk garanton çmime më të lira për konsumatorët. Kundër vendimit të ZRRë-së që të rrisë sasinë e energjisë solare që do të përfitojë tarifa nxitëse kishin dalë: USAID, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ambasada Gjermane, Zyra e BE-së në Kosovë e Sekretariati i Komitetit të Energjisë.

Disa muaj pas këtij vendimi të bordit të ZRRë-së dhe derisa ky vendim ishte i pezulluar nga Gjykata e Prishtinës, në maj të vitit 2020, emisioni “Jeta në Kosovë” ka transmetuar hulumtimin “Monopoli me dritë të diellit – ZRRë dhe Devolli”³⁰. Ky hulumtim zbuloi se Blerim Devolli përmes 6 kompanive, 5 prej të cilave me bazë në Maltë, ka arritur të marrë tarifa nxitëse për 6 megavatë dhe është në listë për të marrë tarifën nxitëse edhe për 10.7 megavatë të tjerë. Emisioni “Jeta në Kosovë” përmes një hulumtimi të gjatë ka zbardhur skemën mbi të cilën kompani në pronësi të Blerim Devollit, të regjistruara në shtetin e Maltës do të përfitojnë nga tarifat nxitëse për prodhimin e energjisë nga dielli.

Hulumtimi zbardhi edhe lidhjet e kompanisë “Electra”³¹, në të cilën është bashkëpronar edhe Selman Hoti, anëtar i Bordit të ZRRë-së, me bizneset e Blerim Devollit. Selman Hoti, anëtar i bordit të ZRRë-së, ka deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsion (AKK) se ka aksione në një biznes të quajtur “Electra”. Hulumtimi i “Jeta në Kosovë” zbulon që “Electra” ka qenë kontraktor i dy kompanive të lidhura me Blerim Devollin, “Birra Peja” dhe “Frigo Food”. Saktësisht “Electra” e ka ndërtuar parkun solar në Gjakovë. Këtë punë “Electra” e ka bërë para se Selman Hoti të emërohet si anëtar i bordit në ZRRë.

³⁰ <https://video.gjirafa.com/emisioni-jeta-ne-kosove-monopoli-me-drite-te-diellit-zrre-dhe-devolli>

³¹ <https://kallxo.com/lajm/anetari-i-bordit-te-zrre-se-electra-ka-shtrire-vetem-nje-kabell-ne-parkun-solar-ne-gjakove/>

Ky emision kishte impakt të madh. AKK³² ka treguar se rasti i Selman Hotit është hapur për hetim pas pyetjeve që i janë dërguar nga emisioni “Jeta në Kosovë”. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës³³ ka thënë se do ta trajtojë në organet e veta përgjegjëse në një kohë sa më të shpejtë që është e mundur. Prokuroria e Shtetit ka njoftuar se Prokuroria Speciale³⁴ ka nisur hetimet lidhur me vendimin e ZRrE-së, për tarifën nxitëse për prodhimin e 20 megavatëve shtesë energji solare.

Përveç kësaj, Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike³⁵ në kuadër të mbledhjes së rregullt, të mbajtur më 19 maj 2020 ka diskutuar për hulumtimin e emisionit “Jeta në Kosovë”. Madje ishte kërkuar hetim parlamentar³⁶ për bordin e ZRrE-së.

Disa ditë pas transmetimit të hulumtimit, më 8 maj 2020 edhe Komisioni për Ndhmë Shtetërore³⁷ nisi procedurë ndaj vendimit të ZRrE-së. Rreth 6 muaj më pas, më 26 nëntor 2020, Komisioni i Ndhmës Shtetërore³⁸ ka konfirmuar hulumtimin e emisionit “Jeta në Kosovë” duke gjetur se skema e aprovuar nga ZRrE për tarifa nxitëse për 20 megavatë energji solare është e kundërligjshme. Nga ky vendim i ZRrE-së përfitonin edhe 4 biznese në pronësi të Blerim Devollit me bazë në Maltë. Pa kaluar një muaj që nga vendimi i Komisionit të Ndhmës Shtetërore, bordi i ZRrE-së me vota unanime ka miratuar vendimin për ndërprerjen e aplikimit të skemës mbështetëse përmes tarifave nxitëse për burimet e ripërtëritshme.

³² <https://kallxo.com/lajm/antikorrupsoni-nis-hetime-per-anetarin-e-bordit-te-zrre-se-pas-pyetjeve-te-emisionit-jeta-ne-kosove/>

³³ <https://kallxo.com/lajm/pas-hulumtimit-te-emisionit-jeta-ne-kosove-per-energjine-solare-autoriteti-i-konkurrences-nis-hetimet/>

³⁴ <https://kallxo.com/emisione/jeta-ne-kosove-prokuroria-speciale-hape-dosje-pas-hulumtimit-te-jeta-ne-kosove/>

³⁵ <https://kallxo.com/lajm/komisioni-per-ekonomi-diskuton-per-monopolin-e-devolleve-ne-energjine-solare/>

³⁶ <https://kallxo.com/lajm/pas-hulumtimit-te-jeta-ne-kosove-kerkohet-hetim-parlamentar-per-bordin-e-zrre-se/>

³⁷ <https://kallxo.com/lajm/hulumtimi-i-emisionit-jeta-ne-kosove-komisioni-nis-hetime-per-vendimin-e-zrre-se-per-te-ndihmuar-bizneset-e-devolleve/>

³⁸ <https://kallxo.com/lajm/komisioni-i-ndihmes-shteterore-shfuqizon-vendimin-e-zrre-se-nga-i-cili-perfitonin-bizneset-e-blerim-devollit/>

³⁹ <https://kallxo.com/lajm/zrre-nderpret-aplikimin-e-skemes-per-tarifa-nxitese-pas-vendimit-te-komisionit-te-ndihmes-shteterore/>

5.2. TELEKOMI I KOSOVËS

Telekomi i Kosovës, një nga ndërmarrjet publike kryesore në Kosovë, pa përfunduar një vit i plotë kalendarik ka ndërruar tri borde, një të rregullt dhe dy të përkohshëm. Në vitin 2020, Telekomi i Kosovës ka hyrë me bordin e rregullt, i cili ishte emëruar nga Qeveria Haradinaj në vitin 2018.

Bordi i Telekomit të Kosovës ishte zgjedhur në mars të vitit 2018⁴⁰. Vetëm tre nga gjashtë anëtarët e emëruar në bord i plotësonin kushtet për emërim sipas vlerësimit të britanikëve. BIRN kishte gjetur se katër nga gjashtë anëtarët e zgjedhur kanë lidhje apo të kaluar politike me partitë në pushtet. Një listë me emra të propozuar ishte dorëzuar edhe nga Komisioni i caktuar nga Qeveria e Kosovës. Edhe ky komision i kishte propozuar 12 emra fillimisht, por e njëjta ishte ndryshuar në rrethana të pasqaruara, duke i shtuar edhe 6 emra të tjerë.

Të zgjedhurit nga ekzekutivi ishin: Besa Shatri, Skender Hoti, Osman Ejupi, Sead Ujkani, Fidel Krasniqi, Suzana Angjelković. Skender Hoti ishte bashkëluftëtar me Fatmir Limajn dhe dëshmitar në rastin "Bellanica". Ai e ka pranuar për KALLXO.com se ka shoqëri me kreun e Nismës Socialdemokrate, por e ka mohuar që është pjesë e Nismës. Besa Shatri - Berisha është gruaja e deputetit të AAK-së, Bekë Berisha. Ajo kishte qenë në listën e ngushtë të Komisioni vendor dhe britanikët, madje ishte njëra nga më të poentuarat. Në listën që e kishte dorëzuar komisioni në Kuvend ajo ishte e para ndërsa në rekomandimet e britanikëve figuronte e katërta.

Sead Ujkani ishte anëtari tjetër i bordit të Telekomit i emëruar nga Qeveria Haradinaj. Ai është mik i deputetit të PDK-së, Mërgim Lushtaku, djalit të ish-kryetarit të Skenderajt, Sami Lushtaku. Kurse Fidel Krasniqi, ishte anëtari tjetër i bordit të Telekomit. Në një postim të AAK-së në vitin 2013 në Facebook, thuhet se Krasniqi i është bashkuar kësaj partie si ekspert. Anëtari tjetër i bordit të Telekomit të Kosovës, Osman Ejupi, në mars të vitit 2019 kishte dhënë dorëheqje morale pas raportimeve se i njëjti kishte punësuar katër fëmijët e tij brenda një muaji në Telekomin e Kosovës.

Në muajin nëntor të vitit 2019, Qeveria e Kosovës e kishte emëruar Shkelzen Ibrahimin si anëtar të Bordit të Telekomit të Kosovës. Ibrahimin nuk i kishte plotësuar kushtet për emërim duke mos u futur në mesin e 12 personave të emërueshëm. Ai ishte emëruar në vend të Fidel Krasniqit, i cili kishte dhënë dorëheqje nga Bordi në fund të muajit dhjetor të vitit 2018. Në atë kohë, Shkelzen Ibrahimin ishte drejtor i Administratës në Zyrën e Kryeministrit. Aty është emëruar në vitin 2012, në kohën kur kryeministër ka qenë Hashim Thaçi, ish-kryetari i PDK-së dhe ish-Presidenti i Kosovës.

Ibrahimin, i cili e ka zëvendësuar Fidel Krasniqin, nuk ishte në mesin e personave të cilët janë konsideruar të emërueshëm për të qenë pjesë e Bordit sipas partnerëve britanikë, BDO-së. Ibrahimin nuk ka qenë as në listën e ngushtë të Komisionit vendor.

⁴⁰ <https://kallxo.com/shkurt/zgjidhen-anetaret-e-bordit-te-telekomit/>

⁴¹ <https://kallxo.com/shkurt/qzeveria-injoron-britaniket-drejtori-i-zkm-se-zgjidhet-anetar-i-bordit-te-telekomit/>

Gjatë qeverisjes Haradinaj, Shekip Fazliu, sekretari i Telekomit të Kosovës, që nga 23 qershori i vitit 2019 ishte zgjedhur edhe kryetar i degës së Nismës Socialdemokrate në Skenderaj. Përderisa në mars të vitit 2019 ai është emëruar nga bordi i Telekomit të Kosovës në pozitën e sekretarit të kësaj ndërmarrjeje, tre muaj më pas, Fazliu kishte ardhur në krye të Nismës Socialdemokrate në Skenderaj. Mirëpo, në një interpretim⁴² të Ligjit për Ndërmarrjet Publike që e ka bërë Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik me rastin e përzgjedhjes së kryeshefit të një ndërmarrjeje publike thuhet se pozitat e larta drejtuese të NP-ve duhet të mbahen nga persona që janë të pavarur.

Në kohën e qeverisjes Haradinaj, në Telekomin e Kosovës ishte rahatuar edhe Vesmira Haradinaj, nusja e Frashër Haradinaj, vëllait të Ramush Haradinajt.

Në vitin 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit kishte gjetur se Telekomit i Kosovës ka angazhuar 65 të punësuar⁴³ për punë dhe detyra specifike, duke mos respektuar afatin e përcaktuar me ligj dhe se në këtë ndërmarrje kanë ndodhur 296 lëvizje të stafit⁴⁴ prej njëres pozite ose gradë në një pozite ose gradë tjetër. Këto gradime që kryesisht ishin avancime, sipas Auditorit, ishin bërë pa ndonjë kriter. Auditori gjithashtu kishte konstatuar se në 61 pozita⁴⁵ në Telekomin e Kosovës, punëtorët me grada të njëjta nuk janë paguar njësoj, si dhe kishte raste të gradimeve pa ndjekur procedura.

Në raportin e Auditimit thuhet se Telekomit i Kosovës ka vazhduar të operojë me humbje. Vetëm në vitin 2019 humbja ishte 26,916,000 euro, në vitin 2018, kjo ndërmarrje kishte regjistruar një humbje prej 15,575,000⁴⁶ euro. Trendi i humbjeve të Telekomit në raportin e Auditorit është përshkruar nga viti 2015. Në këtë vit, humbja totale që i atribuohet pronarëve/aksionarit ishte 7.9 milionë euro. Në vitin 2016 kjo humbje është gjashtëfishuar në 50.9 milionë euro ndërsa në vitin 2017 humbja përsëri ka rënë në 13.9 milionë euro.

Mandati i bordit të emëruar në qeverisjen Haradinaj mori fund⁴⁷ me ardhjen në pushtet të Qeverisë Kurti, e cila nuk priti shumë për ta shkarkuar bordin e politizuar të Telekomit të Kosovës. Kurti emëroi bordin e përkohshëm⁴⁸ me këtë përbërje: Genc Rraci, kryesues dhe drejtor; Naim Maloku - drejtor; Luljeta Elezi - drejtoreshë dhe Teki Shala - drejtor.

Pak më shumë se një muaj nga emërimi i Luljeta Elezit dhe Teki Shalës si anëtarë të përkohshëm të Bordit të Telekomit të Kosovës, Kurti i ra pishman⁴⁹ dhe i shkarkoi ata. Në vend të tyre, Qeveria Kurti kishte emëruar dy anëtarë të tjerë të Bordit të përkohshëm të Telekomit të Kosovës, Lule Ahmedin dhe Hekuran Nikçin.

Pas rënies së Qeverisë Kurti, pasardhësi i tij, Avdullah Hoti, në muajin korrik ka shpallur konkurs për anëtarë të bordit të Telekomit të Kosovës së bashku me 10 ndërmarrje të tjera publike. Me ardhjen në pushtet si kryeministër, Avdullah Hoti nuk vonoi shumë dhe shkarkoi bordin e përkohshëm të Telekomit të Kosovës të cilin e kishte emëruar paraardhësi i tij, Albin Kurti. Qeveria Hoti emëroi bordin e përkohshëm të drejtorëve Telekomit të Kosovës me këtë përbërje: Mehmet Berisha – kryesues; Kushtrim Krasniqi – anëtar; Teki Shala - anëtar dhe Blerim Shehu - anëtar. Kurti e ka rikthyer Teki Shalën në bordin e Telekomit të Kosovës pasi i njëjti ishte shkarkuar nga Kurti muaj më parë.

⁴² <https://kallxo.com/shkurt/interpretimi-ligjor-qe-ia-ndalon-shekip-fazliut-te-jete-sekretar-i-telekomit-dhe-kryetar-i-nismes-ne-skenderaj/>

⁴³ <https://kallxo.com/shkurt/auditori-65-te-punesuar-ne-telekomin-e-kosoves-pertej-afateve-ligjore/>

⁴⁴ <https://kallxo.com/shkurt/296-avancimet-e-dyshimta-ne-telekom-nga-sportelisti-ne-menaxher/>

⁴⁵ <https://kallxo.com/shkurt/diskriminimi-ne-telekom-me-grada-e-pozita-te-njejta-marrin-paga-te-ndryshme/>

⁴⁶ <https://kallxo.com/shkurt/telekomi-i-kosoves-ne-vitin-2018-i-ka-humbur-15-5-milione-euro/>

⁴⁷ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-shkarkon-bordin-e-drejtoreshve-te-telekomit/>

⁴⁸ <https://kallxo.com/lajm/emerohet-bord-i-perkohshem-edhe-ne-telekom/>

⁴⁹ <https://kallxo.com/lajm/albin-kurti-i-bie-pishman-shkarkon-anetaret-e-sapo-emerohet-te-telekomit-te-kosoves/>

6. PUNËSIMET POLITIKE DHE FAMILJARE NË INSTITUCIONE

Punësimet politike dhe familjare nëpër institucionet publike si qendrore ashtu edhe lokale kanë qenë prezente edhe gjatë vitit 2020. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë punësuar këshilltari i ish-ministrit Kujtim Gashi dhe asistentja e ish-zv.ministres së PDK-së; në Teatrin e Qytetit të Mitrovicës është punësuar nusja e djalit të Faruk Mujkës, nënkryetarit të Komunës së Mitrovicës; vajza e Nazmi Hasit, nënkryetarit të Komunës së Drenasit është punësuar si mësimdhënëse në Drenas ndërsa ish-zëvendësministri i PDK-së në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Bekim Jupa, është rikthyer në Administratën Tatimore të Kosovës. Po ashtu bordi i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Çabrat” në Gjakovë është politizuar dhe është anuluar një pjesë e konkursit “të kurdisur” në Trepçë.

KËSHILLTARI I MINISTRIT TË PDK-SË PUNËSOHET NË MKRS

Daut Thaqi⁵⁰, këshilltar politik i ish-ministrit të Kulturës, Kujtim Gashi, ka fituar një vend të ri të punës në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në stafin civil të kësaj Ministrie. MKRS në muajin janar të këtij vitit ka bërë të ditur përmes një vendimi se Daut Thaqi ka dalë si kandidati më i suksesshëm në konkursin për: Zyrtar i Lartë për Integrim të Komuniteteve. Konkursi për këtë pozitë ishte hapur në shtator të vitit 2019, por është riaktivizuar pas vendimit të MAP-it se institucionet mund t'i vazhdojnë procedurat e rekrutimit deri në përfundim të masës së përkohshme që i është vënë ligjit për emërimin e zyrtarëve publik nga Gjykata Kushtetuese. Daut Thaqi, deri në janar 2020 ka kryer pozitën e këshilltarit politik në Kabinetin e ish-ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi.

ASISTENTJA E ISH-ZV.MINISTRES SË PDK-SË PUNËSOHET PA KONKURS NË MKRS

Feime Salihu⁵¹, asistentja e ish-zëvendësministres së Kulturës, Leonora Morina- Bunjaku (PDK) është punësuar pa konkurs në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Salihu është pranuar si asistente administrative në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në MKRS, pa ndjekur asnjë procedurë konkurimi, pak pas përhapjes së pandemisë dhe kur qeveria vendosi masat kufizuese për luftimin e COVID-19. Fillimisht, Feime Salihu në MKRS ishte angazhuar në punë si asistente administrative e ish- zv/ministres Morina Bunjaku

REJA E NËNKRYETARIT TË MITROVICËS PUNËSOHET NË TEATRIN E QYTETIT

Elda Ahmeti, reja (nusja e djalit) e nënkryetarit të Mitrovicës së Jugut, Faruk Mujka⁵² (Vetëvendosje) është punësuar në Teatrin e Qytetit të Mitrovicës “Muharrem Qena”. Elda Ahmeti është punësuar si kostumografe dhe në bazë të shpalljes së Komunës për rezultatet e konkursit për staf teknik- administrativ ka marrë 84% të pikëve. Pas publikimit të rezultateve janë ngritur akuza nga ana e opozitës dhe në rrjetet sociale mitrovicase për kurdisje të konkursit, pasi disa prej të pranuarve janë persona me lidhje familjare me zyrtarëve të Komunës së Mitrovicës, zyrtarë politikë, ish-zyrtarë e të afërm me LVV-në.

⁵⁰ <https://kallxo.com/lajm/keshilltari-i-ministrit-te-pdk-se-punesohet-ne-ministri/>

⁵¹ <https://kallxo.com/kulture/asistentja-e-ish-zv-ministres-se-pdk-se-punesohet-pa-konkurs-ne-ministrine-e-kultures/>

⁵² <https://kallxo.com/punesimet/reja-e-nenkryetarit-te-komunes-se-mitrovices-punesohet-ne-teatrin-e-qtetit/>

VAJZA E NËNKRYETARIT TË DRENASIT PUNËSOHET SI MËSIMDHËNËSE

Vajza e nënkryetarit të Komunës së Drenasit, Nazmi Hasi⁵³, është punësuar si mësimitdhënëse në një shkollë të kësaj komune. Adrianë Hasi është përzgjedhur si kandidatja më e suksesshme për pozitën e mësimitdhënëses të lëndës së Gjuhës Angleze, në shkollën fillore "Fazli Grajqevci" në fshatin Vasilevë. Në bazë të njoftimit të rezultateve të publikuara më 28 tetor, Adrianë Hasi do ta ushtrojë këtë profesion "derisa të kthehet mësimitdhënësi prej funksionit zyrtar". Lidhur me përzgjedhjen e vajzës së nënkryetarit, BIRN ka kontaktuar me Komunën e Drenasit, të cilët përmes një përgjigjeje elektronike kanë deklaruar se nuk mund të penalizohet kandidatja vetëm pse është vajza e nënkryetarit të Komunës.

ISH-ZËVENDËSMINISTRI I PDK-SË BËHET SHEF I HETIMEVE NË ATK

Ish-zëvendësministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bekim Jupa (PDK), është rikthyer në Administratën Tatimore të Kosovës⁵⁴. Bekim Jupa, që është edhe anëtar i Këshillit Drejtues të Partisë Demokratike të Kosovës, është emëruar shef i Hetimeve në Administratën Tatimore të Kosovës. Jupa e kishte pezulluar punën në ATK me rastin e emërimit si zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë. Jupa ka qenë aktiv për një kohë të gjatë në politikë. Ai kishte kandiduar nga PDK-ja për asamblist të Komunës së Gjakovës.

POLITIZIMI I BORDIT TË NDËRMARRJES SË GJAKOVËS

Komuna e Gjakovës e udhëhequr nga Ardian Gjini e ka politizuar bordin e Kompanisë Rajonale "Çabratit". Bordi i "Çabratit"⁵⁵, që është ndërmarrje publike lokale e Komunës së Gjakovës që merret me grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjes së rrugëve është kompletuar më 8 janar 2020. Në bord janë emëruar: Kushtrim Brahimaj, Ardiana Çela Baraku, Jeton Dalladaku dhe Gazmend Hoti. Kushtrim Brahimaj, ishte kandidati me më së shumti pikë të fituara në konkursin e komunës për anëtar të bordit, me 191 pikë. KALLXO.com ka gjetur se Brahimaj ishte sekretar i degës së AAK-së në Gjakovë dhe ishte dorëhequr nga kjo pozitë vetëm një vit më herët. Drejtor i bordit në këtë ndërmarrje është zgjedhur edhe Gazmend Hoti. Hoti në profilin e tij në "Facebook" ka bërë fushatë për të votuar Nismën Socialdemokrate. Ai thotë se nuk është ndihmuar nga partia që të zgjedhet në këtë pozitë. Në njoftimin e Komunës së Gjakovës për listën e ngushtë të kandidatëve thuhet se 5 kandidatë janë eliminuar dhe 4 prej tyre nuk kishin përvojë në menaxhim.

ANULIMI I NJË PJESE TË KONKURISIT "TË KURDISUR" NË TREPÇË

Në prag të zgjedhjeve të parakoshme, më 24 shtator të vitit 2019, në Trepçë⁵⁶ u hap një konkurs për pranimin e më shumë se 200 punëtorëve. Por, pasi u kryen procedurat u shfaqën pakënaqësi ndaj këtij konkursi.

⁵³ <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/vajza-e-nenkryetarit-te-komunes-se-drenasit-punesohet-si-mesimdhene/>

⁵⁴ <https://kallxo.com/gjate/ish-zevendesministri-i-pdk-se-behet-shef-i-hetimeve-ne-atk/>

⁵⁵ <https://kallxo.com/gjate/politizohet-bordi-i-ndermarrjes-se-gjakoves/>

⁵⁶ <https://kallxo.com/lajm/vala-e-punesimeve-ne-prag-te-zgjedhjeve-220-vende-te-reja-te-punes-ne-trepce/>

Për dhjetë ditë me radhë, banorët e rrethinës së Bajgorës protestuan pranë menaxhmentit të Trepçës. E pesë protestues dëshmitë për parregullsi në konkurs i kanë paraqitur në Policinë e Kosovës. Në atë kohë, Policia e Kosovës kishte konfirmuar për KALLXO.com se kanë nisur hetimet⁵⁷. Madje, sipas organeve të hetimeve, prokurori i shtetit kishte kërkuar që të fillojnë grumbullimet e dëshmive.

Emisioni “Jeta në Kosovë” e kishte transmetuar hulumtimin me fakte në lidhje me konkursin e 24 shtatorit të titulluar “Konkursi i kurdisur në Trepçë”. Hulumtimi ka zbuluar edhe lidhjet familjare të dy anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të cilëve u janë punësuar familjarët me këtë konkurs. Në konkursin e 24 shtatorit, në Trepçë është punësuar edhe Arian Shala, kushëri i Ferat Shalës⁵⁸, deputet i Partisë Demokratike të Kosovës.

Pak ditë pas transmetimit të këtij hulumtimi, Qeveria Kurti e ka shkarkuar⁵⁹ bordin mbikëqyrës të Trepçës. Si arsye për shkarkim u përmend edhe konkursi për pranimin e më shumë se 200 punëtorëve në këtë ndërmarrje i cili u hap një ditë pas fillimit të fushatës zgjedhore në vend. Nga ky konkurs kishte përfituar edhe Kreshnik Ibrahim, familjar i Basri Ibrahimit⁶⁰, në atë kohë kryeshf ekzekutiv i Trepçës, i cili është punësuar në këtë ndërmarrje publike.

Disa ditë pas shkarkimit të bordit, Qeveria Kurti emëroi⁶¹ bordin tjetër me këtë përbërje: Sylejman Hyseni, kryesues dhe drejtor; Bahri Hyseni - drejtor; Shyqeri Kelmendi - drejtor dhe Shyqeri Sadiku - drejtor dhe përfaqësues i punëtorëve. Rreth 5 muaj pas shpalljes së konkursit, në shkurt të vitit 2020, ndërmarrja “Trepça” ka anuluar⁶² një pjesë të konkursit për pranimin e punëtorëve të rinj në Stantërg dhe Artanë. Në vendimin e kësaj ndërmarrje thuhej se janë anuluar 38 pozita të ndryshme të konkursit. Anulimi i një pjese të konkursit kishte ardhur pas protestave për 10 ditë me radhë në shenjë pakënaqësie për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve në fazën e parë.

⁵⁷ <https://kallxo.com/lajm/krimet-ekonomike-nisin-hetimet-per-konkursin-ne-trepce/>

⁵⁸ <https://kallxo.com/lajm/kusheriri-i-ish-drejtorit-ferat-shala-punesohet-ne-trepce/>

⁵⁹ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-shkarkon-bordin-mbikqyres-te-trepces/>

⁶⁰ <https://kallxo.com/lajm/kusheriri-i-kryeshefit-basri-ibrahimi-punesohet-ne-trepce/>

⁶¹ <https://kallxo.com/lajm/qeveria-emeroi-bord-te-perkohshem-mbikqyres-ne-trepce/>

⁶² <https://kallxo.com/lajm/anulohet-nje-pjese-e-konkursit-ne-ndermarrjen-trepca/>

7. REKOMANDIMET

- Kuvendi i Kosovës rekomandohet të hartojë një rregullore përmes të cilës e standardizon procedurën e prokurimit. Kjo rregullore, përveç tjerash duhet të rregullojë pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, procesin e intervistimit e deri te mënyra e vlerësimit;
- Anëtarët e komisionit duhet të mbajnë shënime për përgjigjet e kandidatëve, ashtu siç i praktikon kompania angleze BDO;
- Vlerësimi i kandidatëve duhet të bëhet transparent dhe në prani edhe të monitoruesve, në atë mënyrë që secilit deputet/anëtar të Komisionit Vlerësues duhet t'i kërkohet të argumentojë pikët e dhëna;
- Rekomandohet që KQZ t'i obligojë të gjitha partitë politike që të dorëzojnë listën anëtarëve të këshilleve drejtuese dhe kryesive të nivelit qendror por edhe atyre lokale;
- Qeveria e Kosovës rekomandohet që të kërkojë nga KQZ-ja informacione nëse kandidatët për anëtarë të bordeve të ndërmarrjeve publike kanë pozita nëpër parti politike, meqë me Ligj të Ndërmarrjeve Publike persona që kanë ose kanë pas poste në 36 muajt e fundit nëpër parti politike nuk lejohet të bëhen pjesë e bordeve të ndërmarrjeve publike;
- Në bazë të monitorimit të fundit të konkursit për borde të ndërmarrjeve publike është parë që një kandidat ka aplikuar në disa borde. Kjo duhet të ndryshohet në atë mënyrë që të parandalohet që i njëjti person të intervistohet nga disa panele, e shpeshherë nga anëtarë të njëjtë të komisioneve vlerësuese. Në rastet e tilla kur hapen konkurse për bordet e disa ndërmarrjeve, duhet të vendosen kufizime se një kandidat në sa borde mund të aplikojë;
- Për të parandaluar punësimet masive me ligjin për Prokurim, duhet të kushtëzohen që punësimet e tilla të bëhen vetëm pas miratimit të bërë nga Ministria e Administratës Publike (tash Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike), nëse punësimi po bëhet për ekspert apo për pozita/profile/profesionet që veç janë në institucionin përkatës;
- Gjithashtu, duhet të kërkohet miratim edhe nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik për kriteret e vendosura në tenderë për punësime në mënyrë që të eliminohen kurdisjet e tenderëve për persona të caktuar.



British Embassy
Pristina



Projekti "Mbështetja e shoqërisë civile për të rritur mbikëqyrjen publike dhe llogaridhënien e institucioneve publike të Kosovës" është financuar nga Ministria Britanike për punë të Jashtme dhe Zhvillim përmes Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e vetme e BIRN Kosova dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë Britanike për punë të Jashtme dhe Zhvillim.



British Embassy
Pristina

